

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Menaxhmentit Programi: Menaxhimi i Ndërmarrësisë dhe Inovacionit
Titulli i lëndës:	Ndërmarrësia dhe rritja e bizneseve inovative
Niveli:	Master
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I
Semestri:	
Numri orëve në javë:	3
Vlera në kredi:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	
Përshkrimi i lëndës	<p>Lënda është e strukturuar për te përcjell te studentët rëndësinë që kanë ndermarresia dhe rritja e bizneseve inovative për ekonomin e vendit. Ndërlidhjen ndërmjet ndërmarrësisë dhe llojeve të inovacionit si dhe llojet e ndryshme ndermarrësisë, e ndjekur nga një analizë e koncepteve të ndermarrësisë së qëndrueshme.</p> <p>Lënda përmban perkufizimet dhe konceptet themelore te ndermarresise dhe inovacionit. Specifikat e bizneseve dhe rëndësia e inovacioneve ne rritjen e tyre, ndermarreisa dhe krijimi i vendeve të punës, Mjedisi mikro dhe makro i cili ndikon ne rritjen e bizneseve innovative dhe ndermarresise, fushat e veprimit te ndermarresise, trendët e zhvillimit të disa formave të Ndërmarrësisë. Format e organizimit të ndermarrsise, pronësia e ndermarresise, Angazhimet dhe Procesi i krijimit të ndermarresise, Planifikimi i biznesit; Plani i biznesit dhe rëndësia e tij, si dhe temat tjera ndërlidhur me Ndërmarrjet dhe Ndërmarrësin si bartës te procesit dhe inovacioneve.</p>
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës është që studentët të kuptojnë rëndësinë e ndërmarrësisë si dhe ndikimin që inovacionet kanë në rritjen e bizneseve. Të i pergadis studentet per tregun e punes duke nxite tek ta deshiren per ndermarresi.
Rezultatet e pritura të mësimnxënies:	<p>Në fund të kesaj lende, studenti do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Te kuptoj perkufizimet dhe konceptet e ndermarreise dhe inovacioneve • Te kuptoj rolin e ndermarresise • Te njoh mjedisin ne te cilin ndermarresia zhvillohet • Te zhvilloj biznes plane bazike per nje biznes inovativ • Te kuptoje menaxhimin e inovacioneve • Te analizojne procesin e krijimit te bizneseve inovative • Te njiheni me planin e operacioneve ne ndermarrje • Te analizojne dhe interpretojne treguesit financiar

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet teorike/detyra	1	15	15
Punë praktike	2	5	10
Kontaktet me mësimdhënësit – konsultimet	2	5	10
Ushtrime në terren	2	5	10
Kollokuium – seminar			
Detyra të shtëpisë	3	5	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			40
Përgatitja përfundimtare në provim	4	1	4
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	3	6
Projektet, prezantimet etj	1	10	10
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies (dhe mësimnxënies)	<p>Mësimdhënia do të zhvillohet përmes ligjërates, detyrave praktike, interpretimeve individuale e grupore, punimit të seminareve, vetëvlerësimeve periodike, etj. Të gjitha këto do të realizohet në aspektin teorik dhe praktik duke i prezantuar materialet në formën audiovizuale përmes teknologjisë elektronike me programet e Windows Office. Në aspektin teorik do të ofrohen njohuri të përgjithshme shkencore, bazuar në literaturën bashkëkohore. Pjesa praktike kryesisht do të realizohet përmes shembujve konkret nga literatura dhe nga njohuritë praktike të ndërmarrjet prodhuese private e publike dhe të organizatat jofitim prurëse. Në këtë mënyrë do të synohet krijimi i raporteve ndërvepruese profesor–student si dhe ai student-student.</p>		
Metodat e vlerësimit (kriteret e kalueshmërisë)	<p>Vlerësimi dhe forma e ndërtimit të notës për studentet do të mbështetet në tre aktivitetet e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Aktiviteti dhe angazhimi në mësim – vlerësohet me 20 pikë nga 100 pikët e mundshme, Aktiviteti në mësim - nënkupton që studenti të jetë aktive dhe i përfshirë në diskutime interaktive profesor-studentë, studentë-studentë, duke hapur tema të reja që janë të ndërlidhura me lëndën, duke dhënë ide, opinione, mendime kritike me qëllim të nxitjes së debatit gjatë ligjëratave. Angazhimi - nënkupton që studenti të kryejë dhe prezantojë detyrat që caktohen në fund të secilës ligjëratë dhe pastaj diskutohen në fillim të ligjërates vijuese. 2. Hartimi dhe prezantimi i një detyre, projekti/punimi seminarik, vlerësohet me 10 pikë nga 100 pikët e mundshme, Brenda semestrit studenti (mund të jetë një grup i studenteve – jo më shumë se 3 studente) duhet të përgatit një detyrë, projekt/punim seminarik (Word dhe në PowerPoint), i njëjti punim duhet të prezantohet gjatë orëve të caktuara për prezantim. 		

	<p>Tema e punimit mund te propozohet nga profesori dhe nga studenti – tema e propozuar nga studenti duhet te miratohet nga profesori, dhe e njëjta duhet te jete ne korrelacion te plote me lenden.</p> <p>3. Testi i provimit final, vlerësohet me 70 pikë nga 100 pikët e mundshme,</p> <p>Studenti do t'i nënshtrohet testit te provimit final, pas përfundimit të ligjëratave të lëndës dhe organizohet në afatet e provimeve, të përcaktuar nga senati i Universitetit.</p> <p>Qëllimi i provimit është që të vlerësohet njohuria, aftësia, shkathtësia dhe kompetencat e studentit, ndërlidhur me rezultatet e mësimnxënies se parapare për materialin e lendes se ligjësuar.</p> <p>Testi i provimit (formulari me pyetje) duhet te plotësohet ne mënyrë individuale nga studenti dhe i njëjti përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> • pyetje objektive me zgjedhje te shumëfishta alternative, te njëjtat do të shfrytëzohen për të vlerësuar aftësitë e studentit për të rikujtuar dhe njohur konceptet dhe materialin e lëndës, • pyetje subjektive te llojit ese/detyre me shkrim për te cilat vete studenti duhet te jete ne gjendje te jep përgjigje ndërlidhur me materialin e lendes se ligjësuar, te njëjtat përgjigje do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e fituara në analizë, sintezë dhe vlerësim të problemit. <p>Studentët pasi i nënshtrohen provimit, do të ndërtojnë notën përfundimtare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • max 20 pikë - aktiviteti dhe angazhimi në mësim, • max 10 pikë- hartimi dhe prezantimi i detyrës, projektit, punimi/hulumtimit, • max 70 pikë - provimi final <p>Studenti e kalon proviminm., nëse grumbullon 50 pikë nga te gjitha kriteret e vlerësimit</p>
Mjetet e konkretizimit – TI	Përdorimi i tabelës, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori, PowerPoint, etj.
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit	70% Teori, 30% Praktikë
Literatura	
Literatura bazë	[1] M.Mustafa, E,Kutllovci, B.Krasniqi -Biznesi i Vogël dhe i Mesëm; Botuar në 2006; Riinvest [2] Ilan Bijaoui, 2017, SMEs in an Era of Globalization: International Business and Market Strategies
Literatura shtesë	[1] David Campbell & Tom Craig - Organisations and the Business Environment, second edition 4. [2] Ian Worthington and Chris Britton - The Business Environment, fifth edition

Plani i dizajnuar i mësim:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë	Prezantimi – njoftimi i studenteve me syllabusin e lëndës, Përkufizimi i ndermarresise dhe inovacionit; Rëndësia e ndermarresise, inovacionet dhe zhvillimi i bizneseve, Ndermarrresia dhe krijimi i vendeve të punës. Rezultati i pritur nr. 1
Java e dytë	Ndërmarrësia dhe ndërmarrësi si krijues te bizneseve inovaitive; Mjedisi ku vepron beznesi, fushat e veprimit të ndermarresise, trendet e zhvillimit të disa formave të Ndërmarrësisë. Rezultati i pritur nr.2
Java e tretë	Menaxhimi i Inovacionit, përmes Arsimit dhe Menaxhimit të Dijes. Për më tepër, është analizuar roli i Dijes në Inovacion dhe marrëdhënia ndërmjet Dijes dhe Mësimit dhe është paraqitur modeli i Procesit të Njohurisë. Rezultati i pritur nr.6
Java e katërt	Diskutimi mbi llojet e ndermarrësisë. Llojet e ndermarresise dhe analiza e ndermarresise se qendrueshme. Rezultati i pritur nr.2
Java e pestë	Procesi i krijimit te bizneseve inovative Angazhimet dhe Procesi i krijimit të bizneseve inovative Motivët, Përparësitë dhe dobësitë, Kërkesat dhe Aftësitë Personale; Rezultati i pritur nr.7
Java e gjashtë	Mjedisi ne te cilin ndermarrja operon Analiza e mjedisit te brendshëm dhe te jashtëm i biznesit. Rezultati i pritur nr.3
Java e shtatë	Identifikimi i ideve Biznesore. Vlerësimi i një Mundësie Biznesi, brainstormingu i ideve, metoda e selekcionimit të ideve biznesore Rezultati i pritur nr.7
Java e tetë	Plani i biznesit Planifikimi i biznesit; Plani i biznesit dhe rëndësia e tij, përmbajtja dhe elementet e planit të biznesit, hartimi i planit të biznesit. Rezultati i pritur nr.4
Java e nëntë	Plani i biznesit dhe struktura e tij; Analiza e biznesit ekzistues, prezentimi i biznesit, analiza e pozitës konkurruese, objektivat. Rezultati i pritur nr.4
Java e dhjetë	Plani i Operacioneve Analiza Teknologjike ; Plani i teknologjisë, identifikimi i shpenzimeve, identifikimi i investimeve.

	Rezultati i pritur nr.7
Java e njëmbëdhjetë	Interpretimi i treguesve financiar Treguesit e suksesit financiar; Interpretimi i treguesëve financiar. Mjedisi politik, ekonomik dhe socio-kultoror. Rezultati i pritur nr.8
Java e dymbëdhjetë	Struktura organizative. Menaxhimi dhe struktura organizative e biznesit; format e financimit të kapitalit punues dhe të aseteve, menaxhimi financiar, faktorët që ndikojnë në rritjen e biznesit. Rezultati i pritur nr.2
Java e trembëdhjetë	Plani i marketingut Analiza e tregut , hulumtimi i tregut, përkufizimi i konsumatoreve, segmentimi i tregut, analiza e konkurrencës. Rezultati i pritur nr.4
Java e katërbëdhjetë	Vizite praktike ne ndermarrjet e reja inovative.
Java e pesëmbëdhjetë	Prezantimi i punimeve seminarike nga studentet
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p>Studenti është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte ndaj kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në ligjëratat dhe ushtrime është e obligueshme. Gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve NDALOHET ushqimi, pëshpërimat që pengon punën në klasë dhe përdorimi i telefonave mobil. Njëkohësisht, telefonat celularë duhet të fiken ose të vihen në heshtje dhe të mos përdoren gjatë kohës së ligjëratave apo ushtrimeve. Mungesa e integritetit akademik (ku përfshihet plagjiatura, kopjimi i punës së një personi tjetër, përdorimi i ndihmave të paautorizuara në provime, mashtrimi etj) nuk do të tolerohet. Nëse ka dyshime për vërtetësinë e punës së paraqitur, mësuesi ka të drejtë t'i kërkojë studentit të verifikojë punën e tij/saj. Kjo mund të bëhet përmes: përsëritjes së punës, testimit me shkrim ose me gojë, kuiz i papritur apo me çdo veprim tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga ligjëruesi.</p>	